



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 4-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 26.04.2022, në sallën e kuvendit, me fillim në ora 14⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Latif Ramadani, DBF
2. Imri Semetishti DUMJ
3. Kimete Jashanica, OSBE
4. Merita Bytyqi, Sektori i Kuvendit
- 5.

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti *Behar Aliu*.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës e keni marrë dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 3-të e KPF-së.
2. Raporti i buxhetit dhe shpenzimi Janar Mars 2022

3. Propozim Rregullore për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Lipjanit
4. Propozim-Vendim për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal
5. Propozim-vendim për anulimin e vendimit 15 Nr.350/11334 i datës 28.02.2022 për fillimin e procedurës për përmirësimin dhe harmonizimin e mospërputhjeve të vlerave të veçanta teknike të caktuara me hartën zonale të komunës
6. Propozim-vendim për formimin e komisionit Komunal të Aksionarëve

Kryesuesi i Takimit Daut Azemi tha se e kemi edhe një pike shtese nga drejtorati për Buxhet dhe Financa

7. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e vendimit Nr.15-400-11339 për rritjen e buxhetit nga tejkalmi i të hyrave vetanake për vitin 2021 dhe vendimit Nr.15-400/01-11338 për bartjen e të hyrave vetanake të komunës së Lipjanit të vitit 2020 dhe 2021 në vitin 2022

Pastaj Kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime rreh rendit të ditës?

Pasi që nuk pati plotësime as vërejtje kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat, 6 për, aprovoi:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 3-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 6 vota për:

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 3-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës

II

Raporti i buxhetit dhe shpenzimi Janar Mars 2022

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i tha se raportet nuk i diskutojnë po propozoj që të kalojnë direkt në Kuvend .

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, , vendosi që raporti t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Propozim-Vendim për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishti, DPU, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se kam disa pyetje e para a do të kthehen në pikën zero hartat zonale. E dyta me kushtetute të ne janë gjuhë zyrtare Gjuha Shqipe dhe ajo Sreb, spo me duhet e arsyeshme kjo nga ministria për hartat zonale. Çfarë do të veproni tani me harta zonale.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

V

Propozim-vendim për anulimin e vendimit 15 Nr.350/11334 i datës 28.02.2022 për fillimin e procedurës për përmirësimin dhe harmonizimin e mospërputhjeve të vlerave të veçanta teknike të caktuara me hartën zonale të komunës

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën Imri Semetishti, DPU, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne bazë të kësaj që po e shohim ky vendim është goditur në 3 vende dhe po shihet që është bërë gabim dhe me këtë po humbin qytetarët e komunës tonë. Ju rekomandoj që në propozimet tjera të jeni me të kujdesshëm.

Alban Salihu, tha se kam pyetje se me harta aktuale zonale a po ju vështirësohen punët ndërtuesve në komunën e Lipjanit

Imri Semetishti, tha se ministria na ka goditur gabimisht në vendim pasi që ne nuk kemi kërkuar vetëm përmirësimin e gabimeve e jo ndryshim të hartave zonale

Arsim Jashari tha se kur janë diskutuar harta zonale komisioni e as drejtorati nuk i kanë marrë parasysh propozimet që janë ardhur nga subjektet politike e as nga qytetarët. Dhe për këto harta dikush duhet me dhënë përgjegjësi

Alban Salihu, a e kanë edhe komunat tjera të njëjtin problem me harta zonale sikurse komuna jonë.

Daut Azemi, kryesuesi i Kuvendit tha se për hartat Zonale është punuar një kohë të gjatë dhe kjo është marrë nga një kompani për të punuar. Janë marrë parasysh 50% të kërkesave të qytetarëve. Unë personalisht nuk kam pas asnjë ankese sa i përket këtyre hartave.

Mëqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi të procedohet për shqyrtim Kuvendit.

III

Propozim Rregullorë për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasanit drejtor i DKA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se a ka mundësi që të përfshihen në këtë rregullore edhe ata studentë që studiojnë jashtë vendit!

Egzona Bytyqi, tha se e kam analizuar këtë rregullore, kam një propozim që të përfituesit e bursave ma automatizëm të përfshihen edhe personat me aftësi të kufizuara.

Rasim Hasani, tha se të studentet që studiojnë jashtë vendit, ata marrin bursë nga Ministria e Arsimit. Sa i përket asaj të përfshihen personat me aftësi të kufizuara me automatizëm ju si netrat të kuvendit jeni ata që mund të ndryshoni ose jo.

Alban Salihu, tha se duhet me u kuptua qëllimi i bursës se pastaj po bëhen shumë grupe. Të drejtimet deficitare deri me tani nuk ka ndonjë vendim që e cakton cilat janë drejtimet deficitare po shpresojmë që në të ardhmen të dihen cilat janë drejtimet deficitare sipas ndonjë vendimi.

Daut Azemi tha se në të ardhmen mundemi na prapë me ndryshuar këtë rregullore atje ku ka nevojë me shumë, dhe do të ishte mirë që përfituesit e bursës të ishin në bazë të notes mesatare.

Arsim Jashari, tha se pajtohem me kryesuesin që bursa të fillon të ju ndahet atyre që kanë notën me të lartë nga 10 e duke rënë të poshtë.

Mëqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VI

Propozim-vendim për formimin e komisionit Komunal të Aksionarëve

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i a dha fjalën, Latif Ramadanin drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Mëqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me 6 vota për, 1 abstenim vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

VII

Propozim vendim për plotësim ndryshimin e vendimit Nr.15-400-11339 për rritjen e buxhetit nga tejkalimi i te hyrave vetanake për vitin 2021 dhe vendimit Nr.15-400/01-11338 për bartjen e te hyrave vetanake te komunës se Lipjanit te vitit 2020 dhe 2021 ne vitin 2022

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadanit, drejtor i DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të 7 vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15,1⁰

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi